



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __.__.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të organizimit të eventeve – 79952000-2; Shërbime të organizimit të eventeve kulturore – 79952100-3;

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 859 800 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer nëpërmjet tre ofertave., komisioni ka vendosur cmimet në baz të mesatares së ofertave ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.944/3prot,datë 06.02.2026 .

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit (E HAPUR E THJESHTUAR) është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar në sektorin klasik, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”nenin 49 ;në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin11, pika 1, gërma b) dhe neni 55,74,77 i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 2/a .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2 i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 i ndryshuar; si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.i ndryshuar

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklarimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a.Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9 dhe 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik për të përbushur me sukses kontratën.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht: 1500 000 lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit "**Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit**", pika 3 e nenit 77 të LPP i ndryshuar dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 750 000 *lekë*.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ,; dhe në nenin 55, pika 4/ b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt

të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër levrimin e shërbimeve të sipas grafikut të levrimit të shërbimeve bashkëngjitur preventivit shtojca 7 e DST-së.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet OE do të jete i gatshëm të kryejë realizimin e shërbimeve sipas grafikut të levrimit në kohë dhe pa problematika, gjatë zbatimit të kontratës

2.3.3- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" si dhe përcaktimet e pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë se Prokurimit te ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor, **nr.8, datë.10.02.2026**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit"**, me fond limit prej: **3 859 800 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh, lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public, i ndryshuar". Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP . Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE: SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Shpërblime për fituesin, vendi i parë (volejboll):

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 16 persona × 10 000 lekë, të cilat do t'u jepen fituesve.

2. Shpërblime për vendin e dytë (volejboll):

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 16 persona × 5 000 lekë, të cilat do t'u jepen fituesve.

3. Arbitra për volejbollin:

Arbitrat nevojiten për kampionatin që zgjat 1 muaj, sipas kalendarit të miratuar nga autoriteti kontraktor.

4. Topa volejboli:

Topa profesionale.

5. Banket:

Të përfshijë pije, gatime të ndryshme dhe ëmbëlsira, në bizneset e zonës.

6. Cirk për fëmijë:

Aktivitetet të përfshijnë lojëra edukative dhe argëtuese për fëmijë, përfshirë edhe vizatime.

7. Balona:

Të jenë me shumëllojshmëri ngjyrash.

8. Buqeta lulesh:

Të përbëhen nga lule natyrale, të freskëta dhe me dekor.

9. Stilolapsa me logo:

Të jenë me logon e Bashkisë Roskovec dhe me emërtim sipas kërkesës.

10. Kokteil:

Të përfshijë pije, fruta të thata, ushqime të ëmbla dhe të kripura.

11. Çanta rrobash me logo:

Çanta rrobash prej materiali cilësor, me logon e Bashkisë, sipas kërkesës.

12. Libra për fëmijë:

Të shpërndahen libra edukues për dhurata, që mbulojnë tema të ndryshme për fëmijë, të paketuara.

13. Transport:

Transport me kapacitet për 20 persona, për çdo udhëtim deri në 12 km.

14. Kafe:

Ekspres.

15. Këngëtar:

Këngëtarë nga treva të ndryshme, me fokus zonën e jugut, të kenë marrë pjesë në festivale dhe koncerte të mëdha dhe të kenë mbi 5 milionë klikime në YouTube për disa këngë të repertorit të tyre.

16. Kupë:

Për skuadrat fituese, sipas kërkesës.

17. Shpërblime për artizanët / kulinarinë:

Gra me gatime tradicionale, pjesëmarrëse në aktivitetet e bashkisë.

18. Kostume animatorësh:

Kostumet duhet të jenë profesionale, prej materiali cilësor.

19. Dekor festues për fëmijë:

Dekori duhet të jetë me tullumbace dhe me mbishkrim sipas kërkesës.

20. Tullumbace me helium:

Me ngjyra të ndryshme.

21. Juria për konkursin e festivalit “Stephanophana”:

Juria duhet të jetë e përbërë nga profesionistë në ese, video dhe shkrimtarë me emër.

22. Moderator:

Me eksperiencë.

23. Shkrimtarë / Lektorë:

Personalitete në fusha të ndryshme për këshillim karriere, sipas kërkesës.

24. Baner:

Material plastik me përmasa 4 m × 4 m, sipas kërkesës për përshkrimin e aktivitetit.

25. Poster kartoni:

Sipas kërkesës, me përmasa 1 m × 1 m, material kartoni.

26. Ujë:

Ujë natyral 0.5 L.

27. Aktor:

Aktor i njohur për publikun, për të marrë pjesë në aktivitet.

28. Vlerësim për konkursin “Stephanophana”:

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 100 000 lekë për personin që shpallet fitues.

29. Vlerësim – Eseja më e mirë:

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin.

30. Vlerësim – Videoja më e mirë:

Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin.

31. Certifikata me kapak:

Material cilësor.

32. Humorist:

Të ketë marrë pjesë në spektakle televizive.

33. Korniza dekorative:

Brenda saj të vendoset skulptura “Vajza Myzeqare”, e marrë pranë Bashkisë.

34. Skenë + Foni + Ndriçim + Ekran LED:

Skenë me përmasa 7 m × 8 m, që përfshin 20 bokse për mbulimin e muzikës në ambiente të hapura, ndriçim LED, 8 robotë me efekte të veçanta dhe ekran LED sipas përmasave të skenës.

35. Medalje për fituesit e aktiviteteve:

Me pllakë me emërtim dhe emrat e lojtarëve.

36. Vlerësim për fituesit e Kupës “24 Korriku”:

Vlera e pandryshuar: 15 persona × 75 000 lekë për person.

37. Arbitra (futboll):

Sipas kalendarit të miratuar.

38. Poet / Botues:

Sipas kërkesës dhe nevojave të autoritetit kontraktor.

39. Degustues vaji ulliri:

Të kenë eksperiencë në degustimin e vajit të ullirit.

40. Vlerësim për fituesit e vajit të ullirit:

Vlera e pandryshuar: 5 000 lekë.

41. Poster plastik:

Sipas kërkesës, material plastik.

42. Vaj ulliri:

Vaj ulliri cilësor i zonës.

43. Shpërblim për fituesit (sporti):

Vlera e pandryshuar: 3 persona × 10 000 lekë, si shpërblim për aktivitetin e maratonës së vrapimit.

44. Foni + Ndriçim:

Sistemi i fonisë duhet të ketë 20 bokse, pult, mikrofona me stativë për muzikë live dhe mikrofona me valë.

Ndriçimi duhet të përfshijë drita LED dhe robotë për ambiente të jashtme.

45. Medalje “Njeriu i Vitit”:

Medalje druri e veshur me kamosh, me pllakë ari dhe mbishkrim sipas kërkesës.

46. Spektakël fishekzjarresh:

Të ketë mbi 100 shkrepje të llojeve të ndryshme, në orën 24:00, pranë Bashkisë Roskovec, si dhe person përgjegjës për ndezjen e tyre në datë 31/12/2026.

47. Vlerësime për fituesit e “Njeriut të Vitit”:

Vlera e pandryshuar: 13 tituj $\times$ 5 000 lekë për person.

48. Dhurata për fëmijë:

Dhuratat të jenë në çanta kartoni dhe të përfshijnë libra sipas kërkesës dhe ëmbëlsira.

49. Qira për qetë + trajnim (për një ditë):

Kërkohet person për trajtimin e 2 qeve për stërvitje, me qëllim pjesëmarrjen në garën që organizohet në muajin qershor; personi duhet të ketë eksperiencë.

50. Karrocë (qerre):

Sipas kërkesës, me standardet e qerres profesionale të përdorur në vite.

51. Uniforma për garën me qerre:

Sipas kërkesës, për pjesëmarrësit në garë, me mbishkrime dhe logo.

52. Banderolë:

Sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, me përmasa 4 m $\times$ 4 m, material plastik.

53. Roll-Up:

Me mbishkrim sipas kërkesës.

54. Vlerësime për garuesit e “Garës me Qerre”:

Vlera e pandryshuar: 2 persona $\times$ 25 000 lekë.

55. Skenë + Foni:

Sistemi i fonisë duhet të ketë 20 bokse, pult, mikrofona me stativë për muzikë live dhe mikrofona me valë; skena me përmasa 7 m $\times$ 8 m.

56. Kuti druri dhe shishe vaj ulliri:

Kuti druri për shishe 750 ml, me shishe dhe kuti të personalizuar me logon e Bashkisë.

57. Medalje për fituesit e garës me qerre (mini qerre):

Medalja duhet të jetë qerre në miniaturë për pjesëmarrësit.

58. Medalje “Qytetar Nderi”:

E gdhendur në dru, me mbishkrim dhe dizajn të personalizuar sipas kërkesës.

59. Komisioner:

Për numërimin e votave për votimin për aktivitetin “Njeriu i Vitit” 2026.

Shënim: Mallrat dhe shërbimet do të lëvrohen gjatë gjithë vitit, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Anëtarët pranuam specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm :KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.944prot,datë 05.02.2026,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat që do të blejë.:Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes konkretishtë nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik si specifikimet teknike te mallrave dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr. 944/1prot,datë 06.02.2026 dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave/sherbimeve.

Preventivi I hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin: "Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit",

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	Shpërblime për fituesin vendi i parë (volejbolli)	persona	16
2	Shpërblime vëndi i dytë (volejbolli)	persona	16
3	Arbitra për volejbollin	persona	8
4	Topa volejbolli	copë	3
5	Banket	persona	350
6	Cirk për fëmijë	persona	4
7	Balona	copë	15
8	Buqeta lulesh	copë	20
9	Stilolapsa me logo	copë	100
10	Kokteil	persona	255
11	Çanta rrobe me logo	copë	100
12	Dhurata për fëmijë	persona	100
13	Transport	ditë	10
14	Kafe	cope	150
15	Këngëtar	persona	10
16	Kupë	copë	4
17	Shperblime per artizanët /kulinari	persona	20
18	Kostume animatorësh	copë	2
19	Dekor festues për fëmijë	copë	1
20	Tullumbace me helium	copë	250
21	Juria për konkursin e festivalit "Stephanophana"	persona	3

22	Moderator	persona	1
23	Shkrimtar të ftuar	persona	8
24	Postera plastik	copë	10
25	Postera kartoni	copë	10
26	Uji 0.5 L	copë	250
27	Aktor	persona	4
28	Vlerësim për konkursin Stephanophana	persona	1
29	Vlerësim: Eseja më e mirë	persona	1
30	Vlerësim: Videoja më e mirë	persona	1
31	Çertifikata me kapak	copë	40
32	Humorist	persona	1
33	Korniza dekorative	copë	5
34	Medalje "Qytetar Nderi"	copë	7
35	Skenë+foni+ndricim+ ekran LED	copë	1
36	Medalje për fituesit e aktiviteteve	copë	20
37	Vlersim për fituesit e kupës "24 Korriku"	persona	15
38	Arbitra (futbolli)	persona	3
39	Lektor	persona	2
40	Degustues vaji ulliri	persona	2
41	Vlersim për fituesit të vaj ullirit	persona	1
42	Baner	copë	1
43	Vaji ulliri	litra	100
44	Shpërblim për fituesit (sporti)	persona	3
45	Foni+ndricim	copë	1
46	Medalje "Njeriu I Vitit"	copë	13
47	Spektakël fishekzjarresh	copë	1
48	Vlersime për fituesit e "Njeriut të Vitit"	persona	13
49	Dhurata për lexuesit e rinjë	persona	10
50	Komisionerët	persona	5
52	Karroca	copë	2
53	Uniforma për garen me qerre	copë	10
54	Banderol	copë	2
55	Roll-Up	copë	2
56	Vlersime për garuesit e "Garës me Qerre"	persona	2
57	Skenë + foni	copë	1
58	Kuti druri dhe shishe vaj ulliri	copë	21
59	Medalje për fituesit e garës me qerre	copë	2

**GRAFIKU I LËVRIMIT TË SHËRBIMIT PËR OBJEKTIN E PROKURIMEVE ME OBJEK:
"SHPENZIME PËR AKTIVITETE SOCIAL-KULTURORE DHE SPORTIVE TË VITIT".**

Nr.	Emërtimi i Aktivitetit	Data / Muaji i Zhvillimit
1	Kampionati i Volejbollit për të Rritur	Dy herë në vit: Prill–Maj dhe Tetor–Nëntor
2	7–8 Marsi – Dita e Verës	7–8 Mars
3	Dita Botërore e Librit për Fëmijë dhe të Rritur	Prill
4	Të Njohim Qytetin	Prill–Maj
5	Promovimi i Librave të Rinj	Mars–Dhjetor
6	Festa e Serave të Gjelbërta	29 Maj
7	1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	27 Maj – 1 Qershor
8	Festivali Letrar “Stephanophana”	3–4 Tetor
9	24 Korriku	22–24 Korrik
10	Karriera Frymëzon	Dy herë gjatë vitit
11	Festa e Ullirit	Java e fundit e Tetorit
12	“Njeriu i Vitit”	10–30 Dhjetor
13	Gara me Qerre	Qershor

Afatet e ekzekutimit:

Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës mbaron deri më 31.12.2026 ,sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor në përputhje me grafikun e të lëvrimit të shërbimeve.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit,pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t’u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: